

RAPORTI VJETOR I SHBSH-SE 2007

Hyrje

Shoqata e Bashkive në vitin 2007 mbush plot 14 vjet nga krijimi i saj, me iniciativën e 10 Kryetarëve të atëhershëm të bashkive. Që prej asaj kohe Shoqata e Bashkive ka synuar në vazhdimësi të përmbushë misionin e saj, i cili që prej krijimit mbetet në thelb i pandryshuar si më poshtë vijon:

“SHBSH ka si qëllim të kontribuojë për mbrojtjen e interesave të perbashkëta të njësive të vetqeverisjes vendore të qyteteve, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratike në organizimin dhe funksionimin e bashkive dhe zbatimin e parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale”.

Në këtë këndvështrim Shoqata ka përqëndruar aktivitetin e saj në disa drejtime kryesore të cilat kanë marrë mbështetjen e organeve përkatëse të saj dhe në vijëmsi kanë ndikuar në fuqizimin e rolit të Shoqatës në vendimmarjen për çështjen e pushteti vendor.

Sot me krenari mund të themi, që Shoqata është bërë më e pranishme në jetën e përditshme të bashkive në të gjithë vendin. Kryetarët e Bashkive, Kryetarët e Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues të tjerë të tyre, kanë arritur të bashkëpunojnë në forumet e shoqatës përtej dallimeve politike gjë që e vecon Shoqatën e Bashkive si një organizëm në funksion të decentralizimit dhe në shërbim të kauzave të drejta të autonomisë vendore.

Në vijim po ju paraqesim Draft-Raportin mbi veprimtarinë dhe aktivitetet e zhvilluara nga Shoqata e Bashkive. Draft – Raporti është i ndarë sipas pjesëve si më poshtë:

- I. Rinovimi i organeve të Shoqatës së Bashkive
- II. Lobimi
 - a) *Bashkëpunimi institucional*
 - b) *Bashkëpunimi ndërkufitar dhe Integrimi Evropian*
 - c) *Dhënia e mendimeve për projekt aktet normative*
- III. Trajnimet dhe Forumet
- IV. Shërbimet ndaj anëtarëve
- V. Projektet
- VI. Botimet

I. RINOVIMI I ORGANEVE TË SHBSH-SË

Viti 2007 shënoi disa ngjarje të rëndësishme për qeverisjen vendore në Shqipëri dhe për Shoqatën e Bashkive në veçanti. Më poshtë po rendisim disa nga këto ngjarje.

1/ Në muajin shkurt 2007 u zhvilluan zgjedhjet për pushtetin vendor në bashkitë dhe komunat në të gjithë vendin. Nga ky proces dolën organet e reja qeverisëse të bashkive dhe komunave, për mandatin 2007-2011.

2/ Një ngjarje e shënuar është edhe ndryshimi i Kushtetutës për çështjen e kohëzgjatjes së mandatit të organeve të zgjedhura të pushtetit vendor që u ndryshua nga 3 vjet në 4 vjet. Ky ndryshim erdhi edhe si realizim i kërkesës së përsëritur të anëtarëve të Shoqatës së Bashkive për zgjatjen e këtij mandati.

3/ Ngjarja më e rëndësishme për veprimtarinë e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë për vitin 2007 është zhvillimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe rinovimi nëpërmjet zgjedhjes, së organeve drejtuese të SHBSH-së.

Asambleja e Përgjithshme u zhvillua në datën 17 korrik 2007 dhe në të morën pjesë mbi 70% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të saj. Punimet e asamblesë u zhvilluan në ambjentet e Hotel “Tirana International”. Gërshetimi i paneleve tematike, si psh. a) integrimi evropian; b) zhvillimi urban dhe mjedisor; c) zhvillimi ekonomik me mbledhjen e anëtarëve të asamblesë ishte një risi që e ndihmoi këtë eveniment të dilte jashtë formatit të zakonshëm zyrtar.

E vecanta e këtij evenimenti ishte edhe pjesmarrja në punimet e asamblesë dhe mesazhet përshëndetëse të përfaqësuesve të Shoqatave simotra nga Kosova dhe Maqedonia si dhe e donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri. Gjithashtu përshëndetën punimet e asamblesë edhe përfaqësuesit e Qeverisë.

Në përfundim të punimeve të asamblesë, sipas statutit u zhvilluan zgjedhjet për rinovimin e organeve drejtuese të Shoqatës së Bashkive për mandatin 2007-2011.

Në këtë mënyrë u zgjodh si Kryetar i Shoqatës së Bashkive zoti Refik Rrugeja, Kryetar i Bashkisë së Kavajës, u zgjodhën edhe 2 nënkryetarët, Z. Artur Kurti, Kryetar i Bashkisë Kuçovë dhe Z. Lorenc Luka, Kryetar i Bashkisë Shkodër si dhe anëtarët e rinj të Komitetit Drejtues të Shoqatës.

Theksojmë që rinovimi i organeve drejtuese të Shoqatës u bë në përputhje të plotë me statutin e saj, duke ruajtur balancat politike, gjeografike, gjinore dhe të popullsisë.

II. LOBIMI

Lobimi mbetet një nga veprimtaritë kryesore të SHBSH-së për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të bashkive kundrejt aktorëve dhe faktorëve që luajnë një rol në çështjet e decentralizimit dhe pushtetit vendor. Lobimi si një nga veprimtaritë kryesore të Shoqatës është kryer si në planin formal nëpërmjet takimeve dhe përfaqësimeve zyrtare ashtu dhe në atë informal në takime dhe përfaqësime jo zyrtare. Shoqata kryesisht ka marrë pjesë në takime pune dhe grupe të hartimit të politikave nga nivelet më të larta deri tek nivelet e specialistëve. Kjo metodologji pune na ka ndihmuar të jemi në korrent të ngjarjeve dhe të luajmë rol dhe ndikim në mbrojtjen dhe përfaqësimin e duhur të interesave të bashkive. Disa nga proceset më të rëndësishme për pushtetin vendor për vitin 2007, në të cilat Shoqata ka marrë pjesë paraqiten si më poshtë:

Transferimi i ujësjellsave

Shoqata e bashkive i ka kushtuar një vëmendje të veçantë gjatë vitit 2007, procesit të transferimit të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve tek njësitë e pushtetit vendor.

Për këtë çështje Shoqata e Bashkive ka organizuar gjatë 2007, disa seminare dhe tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si

dhe asaj të Ekonomisë. Në këto takime kemi mbështetur bashkitë në plotësimin e kërkesave të tyre për një ecuri pozitive të procesit të transferimit të ujësjellsave.

Megjithatë transferimi i ujësjellsave dhe funksionimi normal i tyre me formulën e propozuar të bashkëpronësisë së aksioneve mbetet një nga angazhimet kryesore të Shoqatës për vitin 2008 për të mbështetur bashkitë me trajnime apo edhe projekte konkrete, në varësi të gjendjes financiare dhe mbështetjes së donatorëve.

Huamarrja vendore

Financat vendore dhe decentralizimi fiskal ka qënë një nga fushat prioritare në veprimtarinë e shoqatës, për vetë faktin që akoma financat e pushtetit vendor nuk janë stabilizuar dhe nuk plotësojnë parametrat e standarteve ndërkombëtare. Shoqata e bashkive në vazhdimësi ka lobuar dhe kërkuar me forcë një decentralizim të mëtejshëm fiskal dhe financiar si në drejtimin kualitativ(cilësor) ashtu edhe në atë sasior.

Këtu përmendim pjesmarrjen e përfaqësuesve të shoqatës gjatë vitit 2006 në grupet e punës për cështjen e hartimit të dokumenteve të politikave dhe projektligjeve të "Huamarrjes Vendore" dhe "Financave Vendore".

Për 2007 theksojmë se në këtë drejtim Shoqata e Bashkive ka ndërmarrë së bashku me Institutin për Studimet Bashkëkohore një fushatë të përbashkët lobimi me kryetarët e bashkive tek Qeveria dhe Kuvendi, për të bërë të mundur miratimin sa më parë të projektligjit "Për Huamarrjen Vendore".

Procesi i hartimit të ligjit të planifikimit tarritorial (urbanistika)

Shoqata e Bashkive e angazhuar në procesin e hartimit të kuadrit të ri ligjor "Për Planifikimin Territorial" ka zhvilluar një sërë takimesh me specialistë të ndryshëm dhe ka konkluduar me disa mendime të Shoqatës mbi projektligjin "Për Planifikimin Territorial", projektligj i cili pritet të miratohet në fillim të vitit 2008 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Një lobim i kryetarëve të bashkive mbetet për tu zhvilluar në fillim të vitit që vjen.

Inspektorati i ndërtimit

Në 2007 kaloi në bashki dhe komuna funksioni i inspektimit në ndërtim. Shoqata u angazhua që në fillim në hartimin e projektligjit dhe në bashkëpunim me specialistët e bashkive dhamë mendimet mbi projektligjin "Për inspektimin ndërtimor e urbanistik". Specialistët e shoqatës morën pjesë edhe në mbledhjen e komisionit parlamentar për ligjet për të bërë të njohur qëndrimin e shoqatës ndaj këtij projektligji. Si pasojë e këtij lobimi disa nene shumë penalizuese për bashkitë u ndryshuan apo u hoqën nga drafti i propozuar në projektligj si psh. neni që bënte fjalë për propozimin për shkarkimin dhe gjobitjen e Kryetarëve të Bashkive dhe Komunave në rast të konstatimit të shkeljeve në inspektoratin ndërtimor nga organet e qeverisë qendrore, nen i cili në mënyrë të dukshme cënonte autonominë e pushtetit vendor.

a) Bashkëpunimi Institucional

Marrëdhëniet me institucionet qeveritare

Nisur nga roli thelbësor që paraqesin institucionet qeveritare në procesin e decentralizimit, për pasojë edhe veprimtaria e lobimit është përqëndruar më shumë në marrëdhëniet me këto institucione. Në 2007 roli i shoqatës është forcuar më tej dhe ka pasur një përfshirje të gjerë në ato institucione apo borde që kanë një ndikim të madh në pushtetin vendor.

Kryesisht Shoqata ka mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme pune me Ministrinë e Brëndshme, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Ministrinë e Financave si tre nga ministritë me ndikim të madh në pushtetin vendor. Por gjithashtu Shoqata është përfaqësuar edhe në marrëdhëniet me institucionet e tjera të nivelit qeveritar.

Përvec pjesmarrjes dhe lobimit në proceset e përmendura më sipër, Shoqata ushtron veprimtarinë e saj lobuese dhe përfaqësuese edhe në mënyrë të institucionalizuar në bordet dhe komitetet shtetërore të ndryshme.

Përfshirja e Shoqatës si anëtare në këto borde e komitete, është një tregues cilësor për punën në rritje të shoqatës dhe për besimin që kanë krijuar tashmë aktorët në fushën e decentralizimit për seriozitetin dhe mirëpërfaqësimin e interesave të bashkive.

Në mbështetje të kësaj, më poshtë paraqiten bordet dhe komitetet kryesore ku SHBSH-ja është anëtare dhe ushtron rolin e saj lobues dhe përfaqësues.

1. Komiteti Ndërministror i Decentralizimit (KND)

KND-ja është organi më i lartë këshillimor për vendimarrjen në çështjet e decentralizimit dhe pushtetit vendor. Në këtë organ Shoqata e bashkive përfaqësohet nga Kryetari I Shoqatës. Gjatë vitit 2007 nuk është zhvilluar ndonjë mbledhje e këtij komiteti.

2. Grupi i Ekspertëve për Decentralizimin (GED)

GED-i është organi konsultativ në ndihmë të KND-së ku Shoqata përfaqësohet me 2 anëtarë në cilësinë e Nënkrjetarit të SHBSH-së. Në 2007 janë zhvilluar dy mbledhje të GED-it ku është diskutuar mbi draftin e Strategjisë së rishikuar të Decentralizimit. Mendimet e Shoqatës i janë përcjellë këtij forumi.

3. Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB)

KKB-ja është organi konsultativ për politikat qeveritare në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë dhe biznesit. Ky organ është rikrijuar në vitin 2006 me ligj të posaçëm dhe SHBSH-ja është parashikuar të ketë përfaqësuesin e saj në këtë Këshill.

Në vitin 2007 anëtari i SH.B.SH-së ka marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli dhe ka shprehur mendimet e për ato çështje që kanë paraqitur interes për pushtetin vendor.

5. Komiteti Ad-Hoc për Grantet Konkurruese

Në vitin 2007 ka vijuar punën Komiteti për ndarjen e Granteve Konkurruese. Në këtë komitet Shoqata ka pasur një përfaqësues të saj. Shoqata ka ndihmuar në vijim punën e këtij komiteti për një përmirësim të vendimarrjes në drejtim të transparencës në ndarjen e fondeve për bashkitë dhe komunat.

6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

FSHZH-ja është një nga fondet e financimit për pushtetin vendor dhe si i tillë në Bordin Mbikqyrës të këtij Fondi, Shoqata është e përfaqësuar me 2 anëtarë.

Për vitin 2007 Shoqata ka mbështetur stafin e FSHZH-së për rritjen e kapaciteteve të saja në drejtim të njohjes më mirë të funksionimit të pushtetit vendor. Shoqata ka mbështetur strategjinë e paraqitur nga FSHZH-ja për tu kthyer në një institucion kreditimi për pushtetin vendor në kuadrin e miratimit të projektligjit "Për huamarrjen Vendore".

7. Instituti Trajnimit të Administratës Publike (ITAP)

Shoqata e Bashkive është anëtare e bordit drejtues të ITAP-it dhe ka përfaqësuesit e saj aty. Përfaqësimi i Shoqatës në këtë bord ka konsistuar në nxitjen për të rritur numrin e trajnimeve të ITAP për bashkitë si dhe përshtatjen e tyre me realitetin vendor. Megjithatë numri i trajnimeve të ofruara nga ITAP për pushtetin vendor në përgjithësi mbetet i limituar dhe për këtë edhe angazhimi i Shoqatës për të përmirësuar këtë gjëndje.

Theksojmë që ITAP synon në strategjinë e saj të zhvillimit krijimin e një qendre të vecantë trajnimi për pushtetin vendor. Shoqata e Bashkive duhet të rishikojë rolin e saj në drejtim të kësaj nisme të ITAP, me qëllim rritjen e ndikimit të pushtetit vendor në trajnime duke e konsideruar këtë ceshtje si një ceshtje që i takon vendimarrjes autonome të pushtetit vendor dhe jo një nisme të centralizuar nga institucione te qeverisjes qëndrore.

Marrëdhëniet me Parlamentin

Marrëdhëniet me parlamentin kane konsistuar në kontaktet me deputete që përfaqësojnë një qëndrim të vazhdueshëm në përkrahjen e decentralizimit dhe pushtetit vendor si dhe me pjesmarrjen në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare për ceshtje të tilla si projektligji për inspektoratin e ndërtimeve apo për buxhetin e shtetit.

Shoqata e bashkive e shikon si një detyrim për të rritur rolin e saj përfaqësues kundrejt parlamentit si organi më i lartë vendimarrës në Shqipëri. Kjo do të mbetet në vijimësi si një prioritet i Shoqatës sonë. Për tu përmendur është fakti që në parlament është arritur të konturohet një grup deputetësh nga të gjitha krahët politik, të cilët janë përkrahës së kauzës së decentralizimit.

Marrëdhënit me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare

Veprimtaria e SHBSH-së në një aspekt të konsiderueshëm varet nga marrëdhëniet me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe që fokus të punës tyre kanë pushtetin vendor. Kryesisht ndihma e donatorëve ka qenë në aspektin financiar, ku janë mbështetur shumica e aktiviteteve të Shoqatës të cilat pa këtë ndihmë nuk do të realizoheshin.

Më poshtë po paraqesim donatorët dhe organizatat ndërkombëtare kryesore që kanë mbështetur dhe mbështesin Shoqatën e Bashkive.

1. Ambasada Hollandeze

Viti 2007 solli edhe përfundimin e projektit të financuar nga Ambasada Hollandeze, e cila ishte donatori kryesor i aktivitetit të Shoqatës, projekt i titulluar “Fuqizimi i decentralizimit nëpërmjet mbështetjes së bashkive të mesme dhe të vogla dhe Shoqatës së Bashkive”. Megjithë suksesin e këtij bashkëpunimi, përfundimi i saj do sjellë vështirësi në realizimin e objektivave të SHBSH-së për periudhën në vijim.

2. Fondacioni gjerman Hanns Seidel

Një nga donatorët më të qëndrueshëm dhe që ka mbështetur Shoqatën tonë, ka qenë fondacioni gjerman Hanns Seidel. Nëpërmjet këtij fondacioni është bërë e mundur realizimi i një sërë trajnimesh dhe

seminaresh në fushën e taksës së biznesit të vogël, inspektimit në ndërtim, transferimit të ujësujellsave etj.

3. Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës edhe për vitin 2007, ka qenë një nga organizatat ndërkombëtare që i ka qëndruar më afër Shoqatës së Bashkive duke e mbështetur si në planin institucional nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta në Kongresin e Autoriteteve Rajonale dhe Lokale gjithashtu edhe në aspektin financiar nëpërmjet financimit të projekteve të ndryshme.

Për vitin 2007 Këshilli i Evropës zgjodhi Shoqatën e Bashkive si partnerin për të realizuar projektin “Programi Shqiptar I LiderShipit”, projekt i cili do të përfundojë në mesin e vitit 2008.

Shoqata jonë është gjithashtu anëtare e Kongresit të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale të Këshillit të Evropës i cili është një nga forumet më të rëndësishëm të këtij karakteri në Evropë.

4. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Shoqata për vitin 2007 ka mbajtur marrëdhënie të mira me OSBE-në dhe e ka patur si partner në bashkëfinancimin e disa projekteve ku më i fundit është projekti i liderShipit në nivelin vendor (bashkëfinancues me Këshillin e Evropës).

NALAS (*Rrjeti i Shoqatave Vendore te Evropes Juglindore*)

Shoqata është një nga anëtarët themelues të rrjetit të NALAS-it, që përfshin të gjitha Shoqatat e Autoriteteve lokale të rajonit të Evropës Juglindore.

Shoqata ka marrë pjesë rregullisht në takimet e rrjetit duke ndikuar në rritjen e bashkëpunimit me të gjitha Shoqatat homologe të Ballkanit por edhe në zhvillimin e kapaciteteve të personelit të saj.

CEMR (*Këshilli Evropian i Bashkive dhe Komunave*)

Shoqata është anëtarësuar edhe në CEMR, që është një nga organizatat me zë të fuqishëm në politiken evropiane kryesisht në nivelin e BE-së. Ajo ka ndikuar në sensibilizimin për çështjen e qeverisjes vendore në Bruksel, duke ndikuar në rritjen e fondeve të BE-së, për njësitë e qeverisjes vendore.

Në këtë organizatë janë të përfaqësuara nëpërmjet Shoqatave të tyre mbi 100.000 njësi të pushtetit vendor nga e gjithë Evropa. Për të theksuar vlerat që mbart kjo organizatë mund të përmendim faktin se një nga Presidentët e saj ndër vite ka qenë ish- presidenti i Francës dhe ish-President i Komisionit Evropian z.Valery Giscard D`Estaing. Sot ky organizëm udhëhiqet nga Kryetari i Bashkisë së Vjenës.

B. Dhënia e mendimeve per projekt aktet normative

Lobimi dhe mbrojtja e interesave të bashkive kërkon domosdoshmërisht edhe dhënien e mendimeve të Shoqatës së Bashkive, për projekt aktet normative që ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në pushtetin vendor.

Për vitin 2007, Shoqata ka dhënë mendim për një sërë projektaktesh normative (ligje dhe VKM) me rëndësi për pushtetin vendor, ku përmendim ato më të rëndësishmet si:

- Projektligji “Për qendrën kombëtare të rregjistrimit”,
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin për Prokurimin Publik”,
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin për sistemin e taksave vendore”,
- Projektligji “Për Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik”,
- Projektligji “Për Planifikimin Territorial”,
- Strategjia e rishikuar e Decentralizimit,

II. TRAJNIMET –FORUMET

Decentralizimi dhe autonomia vendore kërkojnë një nivel të lartë përgatitje nga ana e stafeve të bashkive, në mënyrë që të kryejnë me efikasitet dhe zhdërvjelltësi funksionet dhe kompetencat e besuara atyre, sepse vetë parimi i decentralizimit presupozon kryerjen më të mirë të funksioneve publike nëse zbatohen në nivelin më të afërt të qeverisjes me qytetarët.

Për vitin 2007, pavaresisht mbarimit të projektit me Ambasadën Hollandeze, numri i trajnimeve të ofruara ka qenë i vazhdueshëm. Kjo sepse jemi ndihmuar nga donatorë të tjerë. Tematika e sesioneve të trajnimit ka qenë mjaft e larmishme ku rendisim si më poshtë trajnime të organizuara për:

- taksat dhe tarifave vendore,
- menaxhimin e burimeve njerëzore,
- zhvillimi ekonomik vendor,
- kontrolli dhe auditimi në bashki,
- prokurimi publik,
- inspektimi në ndërtim,
- transferimi i ujës jellsave.

Theksojmë, që pa financimin e donatorëve këto trajnime nuk do të mund të zhvilloheshin dhe në këtë këndvështrim duke pasur në vëmendje uljen e ndihmave nga donatorët, do të duhet që për të ardhmen ky nivel i kënaqshëm trajnimesh të mbështetet nga fondet e vetë bashkive. Kjo do të sillte me tepër qëndrueshmëri për ngritjen në vazhdimësi të kapaciteteve të stafeve të bashkive pavaresisht faktorëve të jashtëm dhe si rrjedhojë edhe më shumë profesionalizëm në kryerjen e funksioneve publike nga bashkitë.

III. SHERBIMET NDAJ BASHKIVE

Shoqata e bashkive përveç veprimtarive dhe aktiviteteve ku përfitues kanë qenë një numër i lartë bashkish, kryen edhe shërbime individuale për bashki të veçanta kryesisht për bashkitë e mesme dhe të vogla.

Këto shërbime mund të karakterizohen si më poshtë:

1. Asistenca juridike

Një nga shërbimet që Shoqata nëpërmjet drejtorisë së saj juridike ka ofruar për anëtarët e saj është dhënia e konsulencës juridike në fushën e prokurimit publik, taksave dhe tarifave vendore, statusi i nëpunësit civil, policia bashkiake etj.. Kryesisht konsulenca është dhënë nëpërmjet komunikimit verbal me telefon dhe e-mail dhe më pak nëpërmjet korrespondencës së shkruar. Bashkitë që kanë përfituar këto shërbime janë bashkitë e Kuçovës, Përmetit, Shijakut, Bilishtit, Korçës, Policanit, Beratit.

Në total janë dhënë mbi **30 këshilla juridike** vetëm për vitin 2007.

Në të ardhmen Shoqata synon të përforcojë sektorin e saj juridik, dhe për rrjedhojë të rrisë edhe më tepër konsulencën e specializuar juridike.

IV. PROJEKTET

Për vitin 2007, Shoqata ka nisur zbatimin e disa projekteve të financuar nga donatorët përkatësisht me Këshillin e Evropës, Bashkimi Evropian, Bankën Botërore etj.. Më poshtë po prezantojmë këto projekte.

Programi i Lidershipit.

Shoqata e Bashkive së bashku me Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe OSI-Hungari, do të zbatojë gjatë vitit 2007-2008 “Programin Shqiptar të Lidershipit”. Ky program ka si qëllim aplikimin e standardeve të përcaktuara nga Këshilli i Evropës për forcimin e lidershipit në 5 bashki pilote nëpërmjet aplikimit të planeve strategjike të zhvillimit.

Bashkitë pilote të përzgjedhura në këtë projekt janë bashkitë e Beratit, Përmetit, Kamzës, Shijakut dhe Laçit. Projekti ka vijuar në gjysmën e tij dhe në janar të 2008 pritet miratimi i planeve të zhvillimit strategjik në këto bashki. Më pas deri në përfundim të projektit do synohet përhapja e këtyre praktikave në bashkitë e tjera nëpërmjet organizimit të një konference kombëtare si dhe financimi i i disa mini-projekteve.

Projekti “Gazeta e Bashkive”

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë filloi të zbatojë projektin “Botimi i Gazetës së Bashkive” me qëllim përmirësimin e informacionit midis bashkive, duke rifilluar botimin e një gazetë periodike. Ky projekt financohet nga USAID nëpërmjet World Learning. Gazeta fokusohet në problemet që bashkitë hasin çdo ditë në aktivitetet e tyre. Botimi mujor i kësaj gazete do ndihmojë zyrtarët e zyrës së informacionit të shkëmbejnë më mirë informacionin dhe eksperiencën e tyre me njëri-tjetrin. Shkëmbimi i informacionit, praktikave më të mira dhe të mësuarit nga eksperiencia e të tjerëve është një kontribut për aktorët e qeverisjes vendore. Gjithashtu gazeta do të përfshihet dhe në faqen tonë të internetit: www.aam-al.com, e cila për momentin është në ndërtim e sipër. Projekti i botimit të gazetës do të financohet deri në muajin mars 2008.

Aktivitetet për periudhën tetor-dhjetor 2007 ishin:

- Ngritja e bordit të gazetës, e cila u realizua në Mbledhjen e Komitetit Drejtues në Sarandë në fillim të shtatorit.
- Takimi me zyrtarët bashkiakë të zyrës së informacionit u organizua në fund të shtatorit në ambientet e shoqatës.
- Përgatitja mujore e gazetës kërkon mbledhjen e materialeve redaktimin dhe editimin e tyre për në shtëpinë botuese. Gjatë periudhës shtator-dhjetor janë botuar tre numra të gazetës.

Projekti: “Për një Qeverisje të Mirë Vendore, Sikur të Isha Kryetar Bashkie...”

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka ndërmarrë 2 projekte në kuadrin e përfshirjes së të rinjve në Qeverisjen Vendore.

Në periudhën 1 dhjetor 2006 dhe 28 shkurt 2007 është zbatuar projekti “Për një Qeverisje të Mirë Vendore, Sikur të Isha Kryetar Bashkie...”, që iu drejtua studentëve të universiteteve shqiptare me qëllimin për të nxitur tek ta idetë kreative se si mund të kontribuojnë në përmirësimin e Qeverisjes Vendore dhe për të thelluar njohuritë e tyre mbi kompetencat dhe rolin e pushtetit vendor.

Pas organizimit të disa sesioneve informuese mbi Qeverisjen Vendore dhe rëndësinë e këtij projekti në disa universitete të Shqipërisë, studentët u ftuan që të marrin pjesë në konkursin e eseve me të njëjtën temë “Për një Qeverisje të Mirë Vendore, Sikur të Isha Kryetar Bashkie...”.

Esetë më të mira u botuan në një libër, botimi i të cilit u mundësua nga NDI (Instituti Demokratik Amerikan) dhe u shpallën 3 cmime te para për esetë më të mira. Kjo përmbledhje esesh i është drejtuar kryetarëve të bashkive shqiptare në mënyrë që ata të marrin në konsideratë opinionin dhe botëkuptimin rinor mbi Qeverisjen Vendore dhe pritshmëritë e tyre prej saj.

Projekti: “Të Rinjtë pranë Qeverisjes Vendore” në Kuçovë

Të Rinjtë pranë Qeverisjes Vendore është një projekt i financuar nga Programi i Granteve të Vogla të Bankës Botërore dhe është zbatuar në periudhën maj, qershor –tetor, nëntor 2007. Ky projekt është zhvilluar në qytetin e Kuçovës dhe kishte si qëllim krijimin e Këshillit Rinor në Bashkinë e Kuçovës si një zë i rëndësishëm i të rinjve në Qeverisjen Vendore.

Të rinjtë përbëjnë një grup interesi shumë të rëndësishëm midis gjithë grupeve të tjera të interesit dhe përfaqësimi i këtyre të rinjve përmes Këshillit Rinor do t'i ndihmojë ata në shprehjen dhe artikullimin e problemeve dhe kërkesave që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ta.

Bashkia Kuçovë dhe Qendra Rinore kanë qenë partner në këtë projekt dhe Këshilli Rinor shërben si një urë lidhëze midis të rinjve, Qendrës Rinore dhe Bashkisë.

Gjatë këtij projekti janë zhvilluar 2 trajnime mbi Pjesëmarrjen e të Rinjve në Qeverisjen Vendore dhe promovimin e Kartës Evropiane të Pjesëmarrjes së të Rinjve në Jetën Vendore dhe Rajonale të miratuar nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale. Janë zhvilluar takime të shumta midis Këshillit Rinor, Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Gjithashtu është informuar opinioni publik përmes shtypit vendor dhe debatit në televizionin vendor.

V. BOTIMET

Një nga veprimtaritë ku është përqëndruar Shoqata ka qenë dhe publikimi i botimeve të ndryshme për bashkitë dhe pushtetin vendor në përgjithësi. Me poshtë paraqiten disa nga botimet e Shoqatës për vitin 2007, të cilat janë financuar nga partnerë të brëndshëm dhe të jashtëm.

- “Aspekte të zbatimit të statusit të nënpunësit civil në pushtetin vendor” botim i financuar nga USAID.
- “Sikur të isha Kryetar i Bashkisë”, financuar në kuadrin e projektit “konkursi i eseve” .
- “Gazeta e bashkive” botim periodik i financuar nga USAID.

Shoqata e bashkive është një institucion demokratik dhe një katalizator i procesit të decentralizimit. Prandaj është detyrë e të gjithë të zgjedhurve vendore dhe administratave të tyre për ta forcuar dhe fuqizuar sepse sëbashku jemi më të fortë. Sepse së bashku dimë më shumë sepse së bashku do ti kalojmë vështirësitë më kollaj.